



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 19.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **URANIKU-SG SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e** bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **URANIKU-SG SH.P.K.**, e dt.19.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 14.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **14.07.2023**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që lëndën ta kthej në ri-vlerësim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.19.07.2023, Operatori Ekonomik " **URANIKU-SG SH.P.K.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "**Furnizimi, montimi, mirëmbajtja dhe mbushja e kondicionerëve**", Nr. i prokurimit- 632-23-5490-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-068-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi juaj i dytë nuk qëndron, sepse sipas FDT-së, janë kërkuar të ketë të kryera punë të ngjashme (jo të njëjta) që dmth të gjitha punët që kanë të bëjnë me furnizim konsiderohen si punë të ngjashme.

**Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës